



KOMUNA - MITROVICË

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KONTRATË –PUNË TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: **Renovimi i objektit te DKRS dhe Bibliotekës**

NUMRI I PROKURIMIT: 642-19-5902-5-3-6

NUMRI I BRENSHEM : 642/19/038/536

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS**

OPERATORI EKONOMIK: " TOSI - V " SH.P.K., Fehmi Agani nr.24, -, PEJË

DATA E NËSHKRIMIT: 27/11/2019

PJESA B: KONTRATA – PUNË

KOMUNA- MITROVICË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

" TOSI - V " SH.P.K., Fehmi Agani nr.24, -, PEJË

, (në vazhdim "Kontraktori"), me nr Biznesi: **71215598**, nr Fiskal: **601542005** nr i tel: **044373553** ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike si vijon: **Renovimi i objektit të DKRS dhe Bibliotekës** - si në vijim:

Neni 1 Lënda: Renovimi i objektit të DKRS dhe Bibliotekës

me numër identifikues.

Nr i Prokurimit: **642-19-5902-5-3-6**

Nr i brendshëm: **642/19/038/536**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **[REALIZIMI I PUNËVE]**, nga punëkryesi i punimeve si në vijim:

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Renovimi i objektit të DKRS dhe Bibliotekës sipas paramasës në DT**.

Renovimi i objektit të DKRS dhe Bibliotekës		7.445,80 €

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **27/11/2019** dhe përfundon me **20/12/2019**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **2 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

REALIZIMI DHE KRYERJA E PUNËVE DUHET TE PËRFUNDOJ MË SË LARGU DERI MË 20 DHJETOR 2019

1.4 Vendi i [kryerjes së PUNËVE është vendi është ndërtesa e DKRS dhe Biblioteka ku do të kryhen punët e parapara sipas DT dhe Njoftimit për Kontratë dhe Përshkrimit të qmimeve.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **[7.445.80–Shtatë mijë e katërqindë e katërdhjetë e pesë euro e 80/100.]**,

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas situacioneve të punëve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të punëve dhe pas pranimit nga komisioni i pranimit dhe raportit të nënshkruar nga ky komision.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

KONTRATË: Renovimi i objektit të DKRS dhe Bibliotekës

Nr i prokur: 642-19-5902-5-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/038/536;

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 MUAJ pas kryrjes së punëve të parapara sipas Paramasës dhe Parallojarisë dhe Pranimit të Teknikë të punëve .

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

KONTRATË: Renovimi i objektit të DKRS dhe Bibliotekës

Nr i prokur: 642-19-5902-5-3-6 dhe Nr i brend: 642/19/038/536;

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:Komuna-Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27/11/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: " TOSI - V " SH.P.K., Fehmi Agani nr.24, -, PEJË	
Emri:	Vlor UKELLA
Pozita:	Drejtor (Pronar i Companisë)
Nënshkrimi:	
Data:	27/11/2019
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

II.2	PUNËT E NGJYROSJES						
2.1	Furnizimi, punimi i fasades strukturore ose gletit - plotësime dhe arnime, në mur / plafon, rreth dyerve dhe në pozita të caktuara, duke përfshirë edhe shtresat pregaditore. Në llogari hyn edhe platforma e punës.	paushall	1	100.00	18.00	118.00	118.00
2.2	Furnizimi dhe lyerja e mureve / plafonit të zyreve, koridoreve dhe shkallëve nga hyrja poshtë deri në zyre, me ngjyrë ekologjike, klasë I, e rezistueshme në fërkime (tip Sto, Gold...apo ngjajshëm), në dy shtresa. Në llogari hyn edhe ngjyra bazë si dhe platforma e punës. Nyanca përcaktohet paraprakisht nga investitori / mbikëqyrësi.	m2	995	1.00	0.18	1.18	1,174.10
Gjithsejtë punët e ngjyrosjes							1,292.10

II.	PUNËT E ZDRUKHTARISË						
3.1	Furnizimi, punimi, montimi i dyerve për zyre, me mbindriqim xham "akull", prej shtuko druri, e plotësuar me panele druri dhe xhami, duke përfshirë dorezat, ventus. Plotesimi me xham dyfish, termo 4+12+6mm. Nyanca dhe dizajni i derës përcaktohet paraprakisht nga investitori / mbikëqyrësi. Dimensionet 100x280cm,	copë	5	250.00	45.00	295.00	1,475.00
3.2	Furnizimi, punimi, montimi i derës kryesore dykrihëshe, me mbindriqim xham "akull", prej shtuko druri, e plotësuar me panele druri dhe xhami, duke përfshirë dorezat, ventus, si dhe mekanizimin hidralik për hapje-mbyllje. Plotesimi me xham dyfish, termo 4+12+6mm. Nyanca dhe dizajni i derës përcaktohet paraprakisht nga investitori / mbikëqyrësi. Dimensionet 170x280cm,	copë	1	300.00	54.00	354.00	354.00
Gjithsejtë punët e zdrukhtarisë / drynarisë							1,829.00

II	PUNËT E DYSHEMESË						
4.1	Furnizimi, montimi i laminatit nga druri artificial 12mm, adekuat për zyre pune. Në llogari hyn edhe bordurat, shtresat parapregaditore dhe pragu/llajsnet adekuate. Në disa pjesë të llogarohet edhe plotesimi me mase adekuate për nivelizim. Nyanca dhe dizajni përcaktohet paraprakisht nga investitori / mbikëqyrësi.	m ²	125	15.00	2.70	17.70	2,212.50
4.2	Furnizimi, montimi i pllakave të qeramikes, klasë I, në dysheme të byfesë. Në llogari hyn edhe bordurat dhe pragu/llajsnet adekuate. Nyanca dhe dizajni përcaktohet paraprakisht nga investitori / mbikëqyrësi.	m ²	20	10.00	1.80	11.80	236.00
Gjithsejtë punët e dyshemesë							2,448.50

PUNËT TJERA							
II.5	Furnizimi, montimi, degezimi, i kabllave te ndriqimit elektrik ne zyre duke i përfshirë kanalet adekuate, si dhe ndriqesit Led 2 cope. Poashtu edhe nje lidhje per interfon/kamere/check, per deren kryesore.						
5.1	Llogarohet komplet	paushall	1	150.00	27.00	177.00	177.00
5.2	Pastrimi detal	paushall	1	10.00	1.80	11.80	11.80
	Gjithsejtë punët tjera						188.80

REKAPITULIMI

I. PUNËT NDËRTIMORE							
I.1.	Punët pregaditore dhe demolimet						861.40
II. PUNËT ZEJTARE							
II.1.	Punët e e murit						826.00
II.2.	Punët e ngjyrosjes						1,292.10
II.3.	Punët e zdrukthtarisë						1,829.00
II.4.	Punët e dyshemesë						2,448.50
II.5.	Punët tjera						188.80

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM

I.	PUNËT NDËRTIMORE	861.40
II.	PUNËT ZEJTARE	6,584.40
	Gjithsejt me TVSH :	7,445.80